

Vendim nr. 207, datë 19.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Asim Vokshi,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 19.06.2026 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 18 (E) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: EDMOND KASMI

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit.

Konstatimi i cenimit të sigurisë juridike dhe cenimi i besimit të publikut se SPAK, gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë do t'i trajtojnë njëllë çështjet e ngjashme ose të patën do t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë kur bëhet fjalë për detyrimin *erga omnes* për të zbatuar vendimin e formës së prerë të gjykatave dhe konkretisht vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1940, datë 16.12.2025 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Deklarimi se vendimi nr. 1, datë 23.01.2023 i Gjykatës Kushtetuese nuk është zbatuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe kjo situatë e paimagjinueshme duhet hetuar sidomos nga juridiksioni i posaçëm penal.

Urdhërimi i rigjyimit të çështjes duke garantuar barazinë e shtetasve përpara ligjit dhe në rastin konkret për moszbatimin me dashje të vendimit nr. 1, datë 23.01.2023 të

Gjykatës Kushtetuese nga personat përgjegjës të Kuvendit të Shqipërisë.

Vendosja e standardit se në rast konstatimi në të ardhmen të situatave ekstreme, siç është moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga kushdo qoftë, institucion, organizatë ose shtet-kartel, duhet të shoqërohet me masa ekstreme si deklarata alarmdhënëse dhe kallëzim penal nga vetë Gjykata Kushtetuese si detyrim normal për të mbrojtur themelet e shtetit ligjor dhe institucionin nga përdhosja dhe përçudnimi barbar narko-diktatorial.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet shtesë të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*)

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ndaj Kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), zëvendëskryetares së tij, disa deputetëve anëtarë të Këshillit të Legjislacionit, anëtarë të Këshillit të Mandateve, zyrtarë të lartë pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe persona të tjerë, duke pretenduar se prej këtyre shtetasve janë konsumuar veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Shkelja e barazisë së shtetasve”, “Moskallëzimi i krimit”, “Pengimi për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” dhe “Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 248, 253, 300, 320 dhe 320/a të Kodit Penal (*KP*).

2. Në kallëzim kërkuesi ka pretenduar se Kuvendi (zyrtarët e tij) nuk ka zbatuar në mënyrë të qëllimshme vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) (*vendimi nr. 1/2023*) që ka vendosur pranimin e kërkesës së një grupi deputetësh, duke

vlerësuar se kërkesa për mbarimin e mandatit të një deputeti duhet të shqyrtohet nga Kuvendi dhe t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim, si instanca e fundit dhe kompetente për këtë çështje, edhe pse ka kaluar rreth 1 vit nga shpallja e vendimit.

3. Prokuroria e Posaçme, me vendimin e datës 19.02.2024, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 40 të vitit 2024, duke vlerësuar se faktet nuk përbëjnë vepër penale. Me pretendimin se ky vendim është haptazi i pabazuar dhe në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore, kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*).

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 147, datë 15.04.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për mosfillimin e procedimit penal, duke lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Posaçme. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, organi i prokurorisë ka arsyetuar në vendimin e tij se kallëzimi i parashtruar në kuadër të nenit 290, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) nuk përmban rrethana që lejojnë fillimin e procedimit, pasi nuk mund të ushtrohet ndjekja penale duke qenë se nuk ka asnjë indicie ose provë që të krijojë dyshimin e arsyeshëm se nga ana e personave të kallëzuar mund të jenë konsumuar veprat penale të pretenduara. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 102 (87-2024-144), datë 30.05.2024, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë si të bazuar në ligj dhe në prova. Sipas GJKKO-së së Apelit, nuk ndodhemi para indicieve që të krijohet dyshimi se qëndrimi i personave të kallëzuar penalisht ndaj vendimit të Gjykatës ka synuar ndihmën dhe shmangien e një deputeteje nga përballja me drejtësinë. Sipas saj, kërkuesi nuk ka sjellë asnjë indicie se përse personat e kallëzuar kanë mbajtur një qëndrim të tillë ndaj vendimit të Gjykatës, në kushtet kur nuk ka edhe një akt refuzimi të zbatimit të këtij vendimi, pra nuk ka të dhëna të mjaftueshme që krijojnë dyshimin e nevojshëm mbi elementet formuese të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, për sa kohë funksionarët e kallëzuar të Kuvendit nuk kanë vepruar në tejkalim të detyrave të tyre funksionale. Po ashtu, në kallëzim nuk ka të dhëna se përse të kallëzuarit, parlamentarë ose funksionarë të Kuvendit, për interes ose për shkaqe të dobëta, kanë mbajtur një qëndrim të tillë mbi hapat dhe procedurën e zbatimi të vendimit të Gjykatës. Sipas GJKKO-së së Apelit, kërkuesi nuk ka përcjellë asnjë të dhënë se një qëndrim i tillë në lidhje me procedurën e ekzekutimit të vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës të jetë nxitur “nga interesi personal ose interesi në favor të një tjetri”, interes ky që mund të ketë diktuar një qëndrim të tillë të të kallëzuarve gjatë ushtrimit të funksionit parlamentar. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-1940, datë 16.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas atij kolegji, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë shkelje të ligjit penal procedural ose material nga gjykatat e posaçme, si dhe nuk rezulton që vendimi objekt rekursi të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 03.04.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij.

8. Në datën 18.06.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve, në zbatim të neneve 36 dhe 37 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarit të Kolegjit për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje dhe ka vendosur zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër për shqyrtimin paraprak të kësaj çështjeje.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt*, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi praktika e Gjykatës së Lartë është e konsoliduar në rastin e shpërdorimit të detyrës dhe në rastet e moszbatimit të vendimeve gjyqësore nga shtetasit dhe zyrtarët e lartë, kurse në rastin konkret aplikohet një standard tjetër kur këto vepra i kryen Kryesia dhe anëtarët e Kuvendit. Për të njëjtën shkelje qytetarët penalizohen, kurse deputetët nuk hetohen e nuk mbajnë përgjegjësi pavarësisht se vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë. SPAK-u dhe gjykatat e posaçme kanë mbajtur qëndrim favorizues ndaj Kryesisë dhe anëtarëve të komisioneve të Kuvendit, të cilët duhet të trajtohen njëjloj si gjithë qytetarët e tjerë, mbi të cilët ligji zbatohet pa hezitim. Kallëzuesi nuk ka detyrim të identifikojë saktë dispozitën përkatëse për faktin konkret, sepse Gjykata e njeh ligjin. Moszbatimi i çdo vendimi të formës së prerë përbën vepër penale.

9.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuesi dhe publiku kanë pritshmëri të cilat nuk mund të eliminohen sipas vullnetit të SPAK-ut. Kërkuesi ka pritshmëri edhe nga Gjykata e Lartë, e cila njëson praktikën, por që në këtë rast ka dhënë një vendim kontradiktor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kolegji vëren se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Po kështu, mospërmbyllja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Kolegji vlerëson të theksojë se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes.

12. Mbi këtë bazë, në vijim, Kolegji do të ndalet në analizën e kriterit të legjitimitit *ratione personae*, që në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete Kolegji vëren se kërkesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të regjistruar mbi kallëzimin e tij, ndaj në aspektin procedural ai legjitimohet, pasi ka qenë palë në proces.

13. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë

ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur mosfillimi i procedimit penal të regjistruar mbi kallëzimin penal të paraqitur nga ai ndaj disa deputetëve dhe disa funksionarëve të Kuvendit për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Shkelja e barazisë së shtetasve”, “Moskallëzimi i krimit”, “Pengimi për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” dhe “Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 248, 253, 300, 320 dhe 320/a të KP-së. Kolegji vëren se thelbi i pretendimeve të kërkuesit lidhet me mënyrën e ekzekutimit të vendimit nr.1/2023 të Gjykatës, me të cilin ajo ka vlerësuar se çështja e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit i takon vlerësimit të saj dhe Kuvendi duhej t’i drejtohet kësaj Gjykate në mënyrë që aspektet e papajtueshmërisë së mandatit t’i nënshtroreshin vlerësimit kushtetues. Për shkak të mosekzekutimit të këtij vendimi, pasi Kuvendi nuk e ka çuar në Gjykatë çështjen e pajtueshmërisë me funksionin të deputetit, kërkuesi ka pretenduar se veprimet e disa deputetëve anëtarë të komisioneve parlamentare dhe deputetëve e funksionarëve të tjerë të Kuvendit përmbajnë edhe elemente të disa veprave penale, duke paraqitur për këtë shkak kallëzim në Prokurorinë e Posaçme.

15. Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi faktet e kallëzuara, në ngarkim të të kallëzuarve, nuk përmbajnë rrethana që lejojnë fillimin e procedimit. Ky arsyetim është gjetur i drejtë nga gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit.

16. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se, ndonëse kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetues, kjo nuk është e mjaftueshme për të justifikuar interesin e tij në çështjen kushtetuese të parashtruar, për sa kohë që nuk ka provuar pasojat reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Kjo sepse, nga njëra anë, kërkuesi nuk ka qenë palë në procedurat parlamentare për të cilat ai pretendon se mbartin elemente paligjshmërie dhe, nga ana tjetër, këto procedura kanë të bëjnë me konstatimin e papajtueshmërisë me funksionin të një deputeti, për të cilat as nuk rezulton, as nuk provohet sesi dhe në çfarë mënyre e prekin kërkuesin ose e pengojnë/kufizojnë në ushtrimin e ndonjë të drejte kushtetuese substanciale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se

kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.